

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Vendimi për ish-krerët e UÇK-së, Gucati apel BE-së dhe ambasadorëve: Mos bëni politikë me 16 shtator in
ADRESA	https://www.gazetatema.net/rajoni/vendimi-per-ish-kreret-e-uk-se-gucati-apel-be-se-dhe-a-mbasadoreve-mos-ben-i585881
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	13 shtator 2026, 18:33:04 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	13 shtator 2026, 18:30:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	13a7019a585f2944ca87cfe7c48e850909fd7e7e0915ce159de9be01e31dc699
TEKSTI	bcc8fcc54dbbbf2628b69285c6395b6e47e3ad4e6a36dbdad3ec91c9fab795ff
PAMJA	33d59153eb72351fcb99bb1c1ff18863879bdf82d8e0c7204cfd296e8b057527

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	2d9c6cc93c689110e34b5cef7cee79f699799b2207ba13db10f437824007523f
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	189cdded276785f170fe9cc7ce5e87625aab0e70d3bc68c5e8e7b4173c15ebbc
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/2d9c6cc93c689110e34b5cef7cee79f699799b2207ba13db10f437824007523f>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)



English



1 e [Vendimi për ish-krerët e UÇK-se, Gucati apel BE-se dhe ambasadorëve: Mos bëni politikë me 16 shtatorin](#) / [Zëvendesministria e Mbrojtjes: Industria e mbrojtjes nuk ndërto fundit](#)

Vendimi për ish-krerët e UÇK-së, Gucati apel BE-së dhe ambasadorëve: Mos bëni politikë me 16 shtatorin



13 Shtator 2026, 20:30Rajoni TEMA



Kryetari i OVL-UÇK-së, Hysni Gucati, u ka bërë thirrje Bashkimit Evropian dhe ambasadorëve të huaj që të mos bëjnë politikë me aktgjykimin që pritet të shpallet më 16 shtator ndaj ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Hagë.

Përmes një postimi, Gucati ka kritikuar deklaratat se procesi gjyqësor nuk përfundon me vendimin e shkallës së parë, pasi palët kanë të drejtë ankese. Sipas tij, një vendim i padrejtë në shkallën e parë do t'i shkaktonte dëme Kosovës, edhe në rast se më vonë do të ndryshohej nga Apeli.

Gucati ka pretenduar se një vendim i tillë mund të përdorej nga Serbia në arenën ndërkombëtare, përfshirë në Organizatën e Kombeve të Bashkuara dhe në fushatat e saj kundër Kosovës.

Kreu i OVL-UÇK-së ka kritikuar gjithashtu punën e Dhomave të Specializuara në Hagë, duke pretenduar se gjatë viteve të procesit është krijuar një narrativë që, sipas tij, i ka shërbyer Serbisë.

Ai ka paralajmëruar se një vendim që, sipas tij, do të kriminalizonte luftën e UÇK-së do të kishte pasoja për perceptimin mbi legjitimitetin e luftës çlirimtare dhe shtetësinë e Kosovës.

Postimi i plotë:

Apeli i veteranëve të UÇK-së për BE-në dhe ambasadorët e huaj

Shumë ambasadorë të huaj, sikurse dhe edhe BE-ja, në përpjekje për t'i menaxhuar pakënaqësitë qytetare lidhur me Gjykatën Speciale, po thonë: më 16 shtator nuk përfundon gjithçka, sepse palët e kanë Apelin.

Veç çka nuk po thonë direkt: "Mos na pengoni t'i dënojmë një herë, sepse në Apel i shpallim të pafajshëm".

Kjo është një lojë e pistë politike me shkallët e drejtësisë. Gjykata Speciale, që nga fillimi, u ka raportuar diplomatëve, sepse është krijuar dhe mbështetur prej tyre. Ajo nuk ka vepruar asnjëherë si një institucion i pavarur i drejtësisë.

Madje, më shumë është dukur e shqetësuar për qëndrimet e përfaqësive diplomatike sesa për gjetjet e organizatave ndërkombëtare lidhur me shkeljet e të drejtave të njeriut që kanë ndodhur aty.

Për gati gjashtë vjet, kjo gjykatë ka prodhuar vetëm narrativë që i ka shërbyer Serbisë. Çdo pretendim të Serbisë e ka adresuar dhe rehabilituar. Pavarësisht mungesës së kredibilitetit të dëshmitarëve serbë, i ka pranuar si dëshmitarë. Pavarësisht paqëndrueshmërisë së dëshmive të tyre, pretendimet serbe janë trajtuar si material për gjykim.

Prandaj, dëshirë e disa ambasadorëve mund të jetë edhe tani që Gjykata Speciale të vazhdojë t'i shërbejë Serbisë me një vendim në shkallën e parë, për ta korigjuar më pas në Apel, siç po tentohet të na thuhet. Por, një vendim i padrejtë në shkallën e parë nuk zhbëhet me një pafajësi në shkallën e dytë.

Dëmi për Kosovën bëhet atë ditë. Historia rishkruhet atë ditë. Serbia e shfrytëzon atë ditë.

Dhe Serbia nuk e pret Apelin. Ajo e përdorë menjëherë një vendim të tillë në OKB, në diplomaci, në fushatën për çnjohjet e Kosovës dhe në përpjekjet e saj për ta delegjitimuar Kosovën si shtet.

Pasojat do të ishin shumë të mëdha edhe brenda Kosovës. Nëse një gjykatë e lidh luftën çlirimtare të Kosovës me kriminalitet të organizuar, dëmi nuk mbetet vetëm në sallën e gjyqit në Hagë. Nga ajo sallë do të kriminalizohet botërisht lufta e UÇK-së.

Dhe bashkë me të do të prekej edhe legjitimiteti i çlirimit të Kosovës, intervenimi i NATO-s dhe vetë shtetësia e Republikës së Kosovës. Nënshkrimi i përfaqësuesit politik të UÇK-së në Rambuje ishte vendimtar për intervenimin e NATO-s. Në koordinim me katër ish-udhëheqësit e UÇK-së që po gjykohen në Hagë, aleanca veriatlantike koordinoi edhe bombardime të ndryshme të caqeve serbe.

Prandaj, një narrativë që e kriminalizon luftën e UÇK-së nuk prek vetëm të kaluarën. Ajo prek edhe bazën politike dhe morale mbi të cilën u ndërtua shteti i Kosovës. Po ashtu, ajo godet edhe karakterin shumetnik të Kosovës, në të cilin bashkësia ndërkombëtare ka investuar që nga viti 1999.

Gjykata Speciale, në rast të një vendimi të padrejtë, Serbisë do t'i jepte municion të ri diplomatik. Një vendim i padrejtë që kriminalizon luftën tonë, në kohën kur Serbia vazhdon t'i mohojë krimet e veta dhe ta glorifikojë aparatin shtetëror që i kreu ato, nuk prodhon paqe.

Prodhon plagë të reja. Prodhon tension. Prodhon konflikt të ri. Bashkësia ndërkombëtare ka investuar 27 vjet duke na folur për paqe, pajtim dhe bashkëjetesë. Prandaj, duhet ta dijë se paqja nuk ndërtohet duke e poshtëruar drejtësinë.

Pajtimi nuk ndërtohet duke kriminalizuar viktimën si palë. Dhe stabiliteti nuk ruhet duke luajtur me plagët e popullit tonë.

Drejtësia nuk është lojë me shkallë, ku dëmi i shkaktuar në të parën harrohet pas vendimit të dytë. Bashkësia ndërkombëtare e ka tradhtuar besimin e Kosovës, sepse ia ka tjetërsuar misionin dhe qëllimin Gjykatës Speciale.

Ajo nuk duhet ta humbasë edhe atë që ka mbetur mes nesh. Vendimi i padrejtë nuk sjell paqe, por konflikt. Dhe kushdo që sot po luan me këtë zjarr, nesër nuk mund të thotë se nuk e dinte çfarë po bënte.

Drejtësia nuk mund të jetë e drejtë vetëm në fund. Ajo duhet të jetë e drejtë qysh në fillim. Prandaj, APELI që veteranët e UÇK-së ia drejtojnë BE-së dhe ambasadorëve të huaj është që të mos bëjnë politikë me vendimin e 16 shtatorit në Gjykatën Speciale. Mos luani më shumë me plagët tona! Mos e bëni këtë gabim!

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

Gjyqi i ish krerëve të UÇK/ Ministri i Drejtësisë së RMV: Respektoni gjykatën dhe vendimin! BDI: Palo-ministër, barazon viktimën me agresorin

19:00 Rajoni

[Kosova me Qeveri të re! Me 62 vota pro, Kuvendi miraton kabinetin e Albin Kurtit](#)

16:16 Rajoni / 13 komente

["Patriotizmi sot paska pushim"/ Përparim Rama ironizon Vetëvendosjen pas votës për deputeten e Listës Serbe](#)

15:50 Rajoni / 7 komente

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.